

Buletini i NFFIS dhe ECO-DRR për Ballkanin Perëndimor

Projekti për Ndërtimin e kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informimit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR
Mars 2021 - Shkurt 2026

Projekti për Ndërtimin e Kapaciteteve për Zvogëlimin e Rreziqeve nga Katastrofat përmes Sistemit Kombëtar të Informimit për Zjarret Pyjore (NFFIS) dhe Eco-DRR

Qëllimi i këtij projekti është të fuqizojë kapacitetet e zyrtarëve qeveritarë në parandalimin dhe zbutjen e zjarreve pyjore dhe katastrofave të tjera natyrore përmes krijimit të NFFIS dhe Eco-DRR.

Fillimi i vitit të dytë

Kur projekti filloi në Mars të vitit të kaluar, ishte e vështirë të realizohej Projekti nga distanca me homologë (C/P) që nuk i kishim takuar kurrë personalisht. Megjithatë, pas vizitave të njëpasnjëshme në Kosovë dhe Mal të Zi, aktivitetet e planifikuara pothuajse janë përfunduar. Viti i dytë filloi në Shkurt 2022, me zhvillimin e modeleve NFFIS dhe Eco-DRR gjithashtu. Në të dy vendet, njerëzit janë të mirë dhe siguria është në nivel të lartë, mjedisi është shumë komod për të punuar, kështu që ekspertët janë në gjendje të bëjnë punën e tyre duke shijuar vërtet jetën atje.



Vendndodhja e kryeqyteteve dhe vendet ku zhvillohet Projekti

Zhvillimi i NFFIS

Lidhur me zhvillimin e aplikacioneve NFFIS dhe prokurimin e pajisjeve, Projekti ka zhvilluar diskutime të projektimit me partnerët dhe inxhinierët, ndërsa ka intervistuar edhe kontraktorët e mundshëm vendas. Nëpërmjet këtyre, Projekti ka përditësuar dizajnin dhe pajisjet e NFFIS për të pasqyruar tendencat më të fundit të teknologjisë dhe për të mundësuar funksionimin e qëndrueshëm afatgjatë. Bazuar në këtë, zhvilluesit dhe furnizuesit e pajisjeve u përzgjedhën përmes thirrjes. Më në fund, është gati të fillojë zbatimin e zhvillimit!

Finalizimi i dizajnit për Restelice

Si një nga aktivitetet Eco-DRR në Kosovë, Projekti planifikon një modelim të një pylli për parandalimin e ortekeve në Restelice, ku ndodhi një katastrofë në shkallë të gjerë ortekeve në vitin 2012. Bazuar në një anketë të kryer vitin e kaluar, një dizajn i detajuar i mbjelljes së fidaneve po kryhet për të krijuar pyje për parandalimin e ortekeve. Mbjellja e fidaneve është planifikuar për në shtator-tetor të 2022 dhe 2023. Ekzistojnë gjithashtu plane për punë ndihmëse për të parandaluar ndodhjen e orteqeve - duke përdorur korniza druri (trekëmbësh) dhe gardhe hekuri - derisa fidanet e mbjella të rriten dhe të funksionojnë për të parandaluar rrëshqitjen e borës. Projekti i punëve ndihmëse ka përfunduar dhe është përcaktuar kontraktori. Punimet e ndërtimit kanë nisur në Korrik 2022 dhe do të përfundojnë në Shtator. Në fillim të Projektit, u propozua një aktivitet tjetër Eco-DRR - një projekt për mbështetjen dhe thyerjen e erërave në Istog në veriperëndim të Kosovës, ku kanë ndodhur dëme të mëdha nga erërat e forta. Promovimi i këtij aktiviteti si një nga aktivitetet e Projektit u miratua zyrtarisht në takimin e dytë të Grupit Koordinues Teknik (GKT).



Shpati i pyjeve për parandalimin e ortekut
Me lartë: Stina e dimrit Poshtë: Vizita në Maj



Survejimi i Pyjeve Bregdetare



Sa i përket ruajtjes së pyjeve bregdetare të Ulqinit në jug të Malit të Zi, qeveria e Malit të Zi ka kërkuar që ato të ruhen për brezat e ardhshëm duke vendosur metoda të mirëmbajtjes dhe menaxhimit përmes ngritjes së vetëdijes publike dhe mbjelljes së fidaneve. Vitin e kaluar, ekspertët Japonezë nuk mund të qëndronin në Mal të Zi për një periudhë të gjatë kohore, kështu që ishte e vështirë të mblidheshin informacione lokale. Megjithatë, si rezultat i fotografimit me dron dhe anketave të intervistave në terren të kryera që nga Prilli i këtij viti, Projekti ka marrë këto informacione;

-Historia e vijës bregdetare aktuale, pyllë bregdetar (pyjet me pisha u mbollën për të parandaluar erozionin e tokës në epokën e Jugosllavisë, por më vonë u përkeqësuan për shkak të zhvillimit të turizmit)

-Bimësia aktuale (pyllë me pisha në perëndim, pyllë i përzier vendas në brendësi dhe në lindje)

-Kushtet aktuale të menaxhimit. Tani e tutje, me bashkëpunimin e universiteteve vendase dhe OJQ-ve, Projekti do të kryejë një studim të detajuar të gjendjes aktuale të pyjeve bregdetare dhe metodave të mëparshme të pyllëzimit, si dhe do të hulumtojë gjendjen aktuale në edukimin mjedisor, i cili do të përdoret në të ardhmen për të krijuar politikat/planet e pyllëzimit dhe për aktivitetet e ndërgjegjësimit mjedisor.



Majtë:

Pyjet bregdetare me pisha (foto nga droni)

Poshtë:

Takimi me palët e interesit për pzjet bregdetare



Prezantimi Medial PR

Tani jemi në Instagram. Ju lutemi na ndiqni së bashku me Facebook.

https://www.instagram.com/w.balkan_nffis_ecodrr_project/

Informacioni mbi projektin është gjithashtu i disponueshëm në faqen e internetit të JICA-s për secilin vend. I gjithë materiali PR mund të gjindet dhe lexohet me kodin QR në të djathtë. Ju lutemi, bëni një vizitë në faqet më poshtë.

Kosovë

<https://www.jica.go.jp/project/english/kosovo/005/index.html>

Mal i Zi

<https://www.jica.go.jp/project/english/montenegro/001/index.html>



Vizita në Mal të Zi e Ambasadorit Japonez në Serbi



Gjatë qëndrimit të tij në Mal të Zi, Ambasadori Katsumata nga Ambasada e Japonisë në Serbi vizitoi pyjet bregdetare dhe vendndodhjen e zjarrit pyjor në lokacionin e projektit në Ulqin.



Summary of Activities

Rezultati 1 - Kosovë

- Kontraktimi për pajisjet dhe Zhvillimin e NFFIS
- Mbledhja e të dhënave për shtresat e NFFIS

Rezultati 2 - Kosovë

- Përfundimi i dizajnit të ndërtimit të pyjeve mbrojtëse nga orteqet
- Kontraktimi i punimeve për pyjet mbrojtëse nga orteqet
- Aktiviteti Opsional (Pyjet mbrojtëse nga erërat) finalizuar dhe kontrata e rishikuar.

Rezultati 1 – Mal i Zi

- Përfundimi i Metodologjisë (udhëzuesi)
- Kontraktimi për blerjen e pajisjeve dhe Zhvillimi i NFFIS
- Mbledhja e të dhënave për NFFIS

Rezultati 2 – Mal i Zi

- Survejimi i pzlilit bregdetar dhe metodat e konzervimit
- Përgatitjet për ngritje të ndërgjegjësimit
- Studimi i përmbajtjes së aktiviteteve opsionale

Project Facebook Page
<https://www.facebook.com/WestBalkanNFFISandEcoDRRProject>



Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) Agjencia e Menaxhimit Emergjent(AME)



Ministria e Brendshme (MB)- Drejtoria e Shpëtimit dhe Mbrojtjes



Japan International Corporation Agency(JICA)